



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT RINISE DHE SPORTIT  
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

Nr. 05/1 prot.

Vau Dejës, më 03, 06, 2021

RELACION

Metodologjia për hartimin e Planit Lokal të Strehimit u bazua si në proces por edhe në përbajtje fillimisht duke mbledhur, organizuar dhe sintetizuar informacionin në dispozicion, nëpërmjet të cilës u krijuar një ide mbi kontekstin e Strehimit Social në vend (nëpërmjet Pyetsorit) dhe situatës në nivel lokal (nëpërmjet Intervistave; mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave me përfaqësues nga Bashkia). Rishikimi i dokumenteve dhe strategjive të planifikimit në nivel kombëtar dhe sidomos në nivel lokal ishte një proces i rëndësishëm prej të cilit u evidentua rëndësia që i është dhënë këtij sektori në këto dokumenta si edhe nevoja e bashkisë për këtë plan. Për të mbështetur këtë plan dhe këtë nevojë fazat pasuese u lidhën me analiza më të detajuara parashikuar kjo edhe në nenin 68 të Ligjit të Strehimit. Këto analiza patën në fokus grupet vulnerabël që ndodhen në territorin e Bashkisë Vau Dejës; nevojën për strehim; numrin e familjeve që do të përfitojnë banesa me kosto të ulët; analiza mbi rreziqet natyrore përfurnizimin me banesa; burimet e financimit; lidhjet e këtij programi me programe të tjera të njësisë së vetëqeverisjes vendore; masën e subvencionimeve nga buxheti i shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe gjithashtu një analizë të përgjithshme për profilin social-ekonomik të bashkisë.

Pas mbledhjes së informacioneve dhe kryerjes së analizave u punua me përgatitjen e dokumentit "draft" të Planit Lokal të Strehimit dhe kaloi në fazë konsultimi me palët e interesuara në nivel lokal.

Faza e fundit mbyllja e raportit final nga konsultimi me palët e interesuara lokale dhe MEFE dhe PNUD dhe përgatitja e këtij Plani Lokal për Bashkinë Vau Dejës.

Konceptoi :

Përgjegjës Sektori i Asistencës Ligjore

Kristinë Shtatri

Miratoi:

Çuka Babani: Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social